



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIJËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIJËS

Nr. 795/1 Prot.

Tiranë, më 16.02.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1813, datë 01.08.2016.

SHOQËRISË “A.T.A EAGLE EXPLORATION” SH.P.K
Pallati Melros, Tiranë

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “A.T.A EAGLE EXPLORATION” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1813, datë 01.08.2016, për mineralin Krom, me vendndodhje Kepenek, Bashkia Tropojë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.457, datë 25.01.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.795, Prot, datë 26.01.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1813, datë 01.08.2016, për mineralin Krom, me vendndodhje Kepenek, Bashkia Tropojë pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me pagesat e garancive financiare të rehabilitimit për vitet 2020 dhe 2021.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1813, datë 01.08.2016, për mineralin Krom, me vendndodhje Kepenek, Bashkia Tropojë që shoqëria Juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1813, datë 01.08.2016, për mineralin Krom, me vendndodhje Kepenek, Bashkia Tropojë.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

